



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-25

Hilmi Krasniqi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 20 qershor 2016.

II. FAKTET

2. Ankesa ka të bëjë me dënimin e ankuesit për vrasjen e rëndë të lëshuar nga Gjykata Themelore, Prishtinë, dhe dënimin që ai ka marrë në lidhje me të dhe ndaj të cili ai ishte ankuar.
3. Dosja e paraqitur në Panel nga ana e ankuesit nuk përmban asnjë nga aktgjykimet e përmendura në ankesë dhe Sekretariati ka marrë këto

aktgjykime nga administratorët e Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, si dhe sqarimin e vendimit nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

4. Me 18 tetor 2013, Gjykata Themelore, Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka gjetur ankuesin fajtor për vrasje të rëndë dhe e ka dënuar me 22 vjet burgim.
5. Me 27 mars 2015, Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë ankesën e paraqitur nga ankuesi ndaj ashpërsisë së dënimit të tij, ka miratuar ankesën e parashtruar nga prokurori dhe ka rritur dënimin me 25 vjet burgim.
6. Ankuesi ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me 26 maj 2016, ndërsa Gjykata Kushtetuese ka shpallur këtë kërkesë të papranueshme me 17 shkurt 2017, sepse ajo ishte parashtruar jashtë afatit.

III. ANKESAT

7. Ankesa ka të bëjë me procedurën penale në Gjykatën Themelore, Prishtinë, që kishte kulmuar me një aktgjykim të Gjykatës së Apelit të datës 27 mars 2015.
8. Ankuesi pohon se një nga gjykatësit e EULEX-it nuk ishte i caktuar për lëndën në mënyrë të duhur nga kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it. Ankuesi më tej pohon se atij nuk iu ishte lejuar që t'i drejtohej gjykatës gjatë gjykimit dhe se ai nuk ka mundur të mbrohej në mënyrë efektive. Kjo ka rezultuar në një vendim që pretendohet si i padrejtë, në të cilin ai ishte dënuar me burgim për një krim që pretendohet se ai nuk e kishte kryer. Prandaj, ankesa duket se lidhet me një shkelje të supozuar të të drejtave të ankuesit në të drejtën për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa") (dhe nenit 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike).

IV. LIGJI

9. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

10. Para shqyrtimit të ankesës mbi bazueshmërinë e tij, Paneli duhet të vendosë nëse do të pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
11. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.
12. Ankesa ka të bëjë me procedurat penale në Gjykatën Themelore, Prishtinë dhe ankesat e mëvonshme. Në përgjithësi kjo përfshinë pretendimet për padrejtësi, sugjerim që një nga gjykatësit e EULEX-it nuk ishte i caktuar në mënyrë të duhur në këtë rast dhe se ankuesit i ishte mohuar mundësia që të fliste në gjykatë.
13. Paneli ka konstatuar në shumë raste se sipas rregullës 25, paragrafi 1, i bazuar në konceptin e llogaridhënies të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, në parim nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës (*Z.A. kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 shkurt 2016, paragrafi 17 dhe referencat e cituara). Fakti që gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupin gjykues në ndonjë gjykatë të caktuar, nuk ia humb asaj gjykate karakterin e të qenurit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (*ndër të tjera*, shih midis të tjerash *Halili kundër EULEX-it*, nr. 2012-08, 15 janar 2013, paragrafi 21, *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012-05, 4 tetor 2012, par. 9-10, *Dobruna kundër EULEX-it*, nr. 2012-03, 4 tetor 2012, paragrafi 12).
14. Prandaj rezulton se ankesa bie jashtë mandatit të Panelit, siç është saktësuar në Rregullën 25 të rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese